



Datë: 30.12.2025
Numër Protokolli: 8156/2025

A.nr.1531/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1531/2025, të datës, 04.08.2025, të parashtruar nga ankuesi E.R, kundër organit të punësimit: Organi Shqyrtues i Prokurimit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1531/2025, e datës 04.08.2025, e parashtruar nga ankuesi E.R.

II. Mbetet në fuqi Akti Përfundimtar/Njoftimi me Nr.1003/25, i datës 21.07.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me shpalljen e kandidatit fitues për procedurën e pranimit me numër reference RN00017935, pozita Zyrtar i Lartë i Teknologjisë, në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil E.R (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 04.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokolli Nr.1003/25, të datës 21.07.2025, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017935, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë i Teknologjisë Informative, të shpallur nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të LPPA-së administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5212/2025, të datës 04.05.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Provat shtesë të dërguara nga ankuesi më datë 07.09.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.08.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 27.08.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Rënditjen përfundimtare nga SIMBNJ, të datës 21.07.2025; Formularët e vlerësimit të eses të datës 16.07.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 21.07.2025; Aplikacionin me datë aplikimi 13.06.2025 të kandidatit E.R së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 23.06.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Testin me shkrim të kandidatit fitues A.V të datës 15.07.2025; Testin me shkrim të ankuesit E.R të datës 15.07.2025; Lista e kandidatëve të aprovuar; Njoftimin e datës 21.07.2025; Njoftimin mbi rezultatet përfundimtare të datës 21.07.2025; Njoftimin e datës 17.07.2025; Konkursin me numër reference RN00017935; Njoftimin e datës 09.07.2025; Njoftimin e rezultateve të testit me shkrim të datës 16.07.2025; Vendimin e datës 10.07.2025; Kërkesën për shpalljen e procedurave të datës 29.05.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë i Teknologjisë Informative; Akt emërimit të datës 08.07.2025; Akt emërimit të datës 29.04.2025; Akt emërimit të datës 01.08.2025; Akt emërimit të datës 13.11.2025; Akt emërimit të datës 18.06.2025; Vendimin e datës 20.05.2025; Vendimin me numër protokolli 6207/2025, të kryetarit të Këshillit; Prova shtesë të datës 29.09.2025 (E-mailin e datës 29.09.2025, të KPMSHCK dhe E-mailin e datës 29.09.2025 të OSHP-së).

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Vlerësimi i gjendjes së fakteve

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh:

-Organi Shqyrtues i Prokurimit më datë 29.05.2025, ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00017935, për Grupin e Teknologjisë Informative, pozita e punës Zyrtar i Lartë i Teknologjisë, me klasë të pozitës Profesional 1, një vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 30.05.2025 deri më 28.06.2025.

-Në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesi i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke u konsideruar që ka plotësuar kushtet e konkursit, dhe se i njëjti i është nënshtruar vlerësimit profesional, ashtu që, në testin me shkrim ka arritur 53.2 pikë, ndërsa në intervistën me gojë më 24.6 pikë, gjithsej 78 pikë, mirëpo, sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të vlerësimit ankuesi është renditur si kandidati i dytë me më shumë pikë të arritura, rrjedhimisht, si kandidat me më shumë pikë rrjedhë të jetë A.V me gjithsej 84.2 pikë, ashtu që, edhe i njëjti është shpallur edhe kandidat fitues sipas Njoftimit me numër protokolli Nr.1003/25, të datës 21.07.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet ankimore

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kundërshtuar si të kundërligjshëm procesin e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN000017935. Shton se procedura është përcjell më shkelje ligjore dhe procedurale, mungesa e komenteve në formularët e vlerësimit të intervistës, gjegjësisht bazuar në formularët e vlerësimit rrjedhë së anëtarët e komisionit të pranimi kandidatin fitues e kanë vlerësuar në intervistë 27.6 më pikë, duke mos dhënë sqarime dhe komente për vlerësime maksimale duke u shkelur nenin 13.3 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Tutje, ankuesi pretendon se ka pas subjektivizëm në vlerësimin e testit me shkrim, duke u shkelur parimet e objektivitetit dhe dokumentimit. Rrjedhimisht, njëri prej anëtarëve të komisionit vlerësues, konkretisht z. A.R, i ka dhënë vlerësim maksimal prej 20/20 pikësh në pjesën e esesë por asnjë koment, sqarim apo arsyetim nuk është dhënë në formular për këtë vlerësim maksimal, ndonëse Rregullorja Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit, kërkon koment për çdo vlerësim maksimal ose minimal. Me tej ankuesi deklaron se dyshon se kandidati fitues të ketë përmbushur kriterin e përvojës së punës, pasi që sipas dokumenteve të siguruar nga qasja në dokumente zyrtare rrjedhë së kandidati fitues ka vetëm një kontratë individuale pune me kompaninë private "Kutia SH.P.K.", të datës 06.03.2025, si dëshmi vetme e paraqitur dhe nuk mbulon periudhën e kërkuar dyvjeçare të përvojës profesionale para datës së aplikimit. Po ashtu, kjo kontratë nuk është shoqëruar me dëshmi të kontributeve pensionale. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën dhe të rishqyrtoj të gjitha fazat e vlerësimit nga ana e Komisionit të Pranimi.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me numër reference RN00017935 dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën e Zyrtar i Teknologjisë janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Fusha e studimit: Shkenca kompjuterike, Inxhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inxhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji informative, Inxhinieri Elektroteknike Kompjuterike dhe Telekomunikacion. Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku dy vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore të çështjes iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, që rregullojnë procedurat e pranimi në shërbim civil, më theks të veçantë:

- **Nenit 9 paragrafi 1:** *[Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik].1Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion*

publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2. Përgjithshëm, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkohej kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministritë përgjegjëse për administratë publike

- **Nenit 39** [Procedura e pranimit në Shërbimin Civil]: 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjithshëm përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar prapë prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”.

- **Nenit 40**” 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/e civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/e nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/e i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.

Po ashtu, për vendosje të drejtë dhe meritore Kolegji mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, respektivisht:

- **Nenit 6**, paragrafi 2: 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;

2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruar në aplikacion.

- **Nenin 9:** 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 6/22 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.

- **Nenit 10** paragrafi 2: 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.

- **Nenit 11** paragrafi 2,: 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNJ, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër Kolegji i Këshillit ka konstatuar së kriteret e përgjithshme formale kanë qenë në pajtim me rregulloren në fuqi për klasifikimin e endeve të punës në shërbim civil (Rregullorja nr.06/2024) dhe së Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit Nr.950/25 të datës 10.07.2025, të U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të OSHP-së, është në përbërjen e përcaktuar më nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Në ndërlidhje me pretendimin e ka pas subjektivizëm në vlerësimin e testit me shkrim, duke u shkelur parimet e objektivitetit dhe dokumentimit, Kolegji fillimisht ka theksuar faktin së ankuesi i referohet Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim civil, e cila rregullore nuk gjendet në fuqi pasi që Ligji Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil si akt ligjor nga i cili buron kjo rregullore është shfuqizuar më Ligjin nr.06/L-114 i aplikueshëm nga data 10.07.2020 deri 24.07.2023, ndërsa nga data 25.07.2023 është në fuqi dhe rrjedhimisht i zbatueshëm Ligji 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Në fakt, në kontekst të këtij pretendimi, Kolegji nga provat e çështjes ka gjetur së testi i aplikuar në këtë procedurë rekrutimi ka përmbajtur 25 pyetje më përgjigje të tipit shumë opsione dhe një pyetje në formë të eseja, ashtu

që kandidati fitues ka dhënë 21 përgjigje të sakta duke arritur 42 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më nga dy pikë), vlerësim ky që behët nga sistemi elektronik, kurse, në ese si vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimit kandidati fitues është vlerësuar më 14.6 pikë, nga 20 pikët maksimale, duke arritur gjithsej 56.6 pikë, ndërsa, ankuesi ka dhënë po ashtu 21 përgjigje të sakta duke arritur 42 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më nga dy pikë), kurse në ese si vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimit, ankuesi është vlerësuar më 11.2 pikë, nga 20 pikët maksimale, gjithsej 53.2 pikë. Rrjedhimisht nga analizimi i eses se përshkruar nga ankuesi dhe kandidati, Kolegji verën së kandidati fitues kishte dhen shpjegim të detajuar të temës së eses, ndërsa, ankuesi ka dhënë sqarim më të shkurtër, e që mbi këto rrethana, Kolegji nuk mund të argumentoj vlerësim jo të drejtë të ankuesit në ese.

Lidhur me pretendimin së anëtari i Komisionit të Pranimit A.R, ka dhënë vlerësim maksimal në ese lidhur më kandidatit fitues gjegjeshit 20 nga 20 pikët maksimale duke mos dhënë asnjë koment, sqarim apo arsyetim në formularin e vlerësimit, Kolegji vlerëson së një pretendim nuk ka mbështetje ligjore sepse Ligji 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullorja (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil nuk përmbajnë ndonjë kërkesë ligjore që anëtarët e komisionit të pranimit duhet të arsyetojnë vlerësimin e eses çdo herë ku vlerësimi është maksimal dhe së një kërkesë të tillë nuk e përmbajnë as formularët e vlerësimit si pjesë e shtojcës 1 të kësaj rregullore.

Referuar pretendimit se anëtarët e komisionit të pranimit kandidatin fitues e kanë vlerësuar në intervistë 27.6 më pikë, duke mos dhënë sqarime dhe komente për vlerësime maksimale, Kolegji thekson së formularët sipas shtojcës 1 të Rregullores QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil kërkojnë komente në rast te vlerësimit minimale apo maksimal, mirëpo në rastin e kandidatit fitues nuk janë dhënë pikë maksimale (30 pikë), andaj dhe nuk ka qenë e nevojshme evidentimi i komenteve dhe sqarimit nga anëtarët e komisionit të pranimit.

Përkitazi me pretendimin se kandidati i përzgjedhur nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës lidhur më pozitën e kontestuar pasi që i njëjti ka vetëm një kontratë individuale pune me kompaninë private "Kutia SH.P.K.", të datës 06.03.2025, e cila nuk mbulon periudhën e kërkuar dyvjeçare të përvojës profesionale para datës së aplikimit dhe e cila nuk është shoqëruar me dëshmi të kontributeve pensionale. Kolegji ka analizuar dokumentacionin e kandidatit fitues A.V nga dhe konstatoi se i njëjti nga fusha e arsimit posedon: Diplomën Nr.231/21, të datës 23.02.2021, të lëshuar nga Kolegji AAB-Prishtinë, me të cilën vërtetohet se i njëjti më datë 15.02.2021, ka përfunduar studimet themelore në Shkenca Kompjuterike, duke fituar, gradën Bachelor i Shkencave në Shkenca Kompjuterike, ndërsa, përkitazi me përvojën e punës i njëjti në formularin e aplikimit të datës 23.06.2025, ka deklaruar së ka qenë punësuar në pozitën e Zhvilluesit të softuerit në kompaninë “ Kutia shpk” në periudhën kohore 06/02/2023 - 06/04/2025. Lidhur me këtë përvojë të punës ka bashkangjitur Njoftimin (*për ndërprerjen e marrëdhënies së punës*), të datës 06.03.2025, të lëshuar nga punëdhënësi kompania Kutia Sh.p.k, sipas të cilit konfirmohet se ankuesi ka qenë i punësuar si inxhinier softueri dhe atë nga data 26.02.2023 deri me 05.04.2025, përvojë të cilën e ka argumentuar më Listën e pagave nga Administrata Tatimore e Kosovës të datës 10.04.2025 si dhe me Pasqyrë të Trustit të datës 23.06.2025. Andaj, nisur nga gjendja e fakteve të evidentuara si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin se kandidati A.V ka përmbushur kriteret formale për pozitën e shpallur, e duke qenë së i njëjti ka arritur të grumbulloj numër më të madhe të pikëve të vlerësimit, atëherë, njësia përgjegjëse të njëjtin e ka shpallur si kandidat fitues për pozitën kontestuese në pajtim me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil,

rrjedhimisht, nuk gjen mbështetje pretendimi ankimor lidhur me faktin se kandidati fitues nuk ka plotësuar kriteret formale lidhur me pozitën përkatëse.

Bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si me lartë, dhe duke qenë se nuk është evidentuar ndonjë shkelje esenciale ligjore, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura e kontestuar më ankesë është zhvilluar në pajtim më Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për këto arsye, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi: Refuzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të Aktit Përfundimtar/Njoftimit më Nr.1003/25, të datës 21.07.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me shpalljen e kandidatit fitues për procedurën e pranimit më numër reference RN00017935, pozita Zyrtar i Lartë i Teknologjisë, në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1531/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, E.R;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.